



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

VENDIM

K.P.P. 655/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.09.2017, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

-Shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të B.O.E ankimes “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Kthesë e Pilurit (Himarë) - Vumblo”, me nr. REF-13847-05-19-2017, me fond limit 139,137,617 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

Ankimues:

B.O.E “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k.
Adresa: Lagjia nr.2, Pallati 46, Sarandë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Himarë
Adresa: Spile, Himarë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga B.O.E ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, B.O.E ankimues kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. B.O.E kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të B.O.E ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 22.05.2017, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruksion i rrugës Kthesë e Pilurit (Himarë) - Vumblo”, me nr. REF-13847-05-19-2017, me fond limit 139,137,617 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.

II.2 Në datën 16.06.2017, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 03.07.2017, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|---------------------------------------|-----------------------------------------|
| 1. “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. | 119,111,111 lekë pa tvsh, skualifikuar; |
| 2. ”Salillari” sh.p.k | 136,485,450 lekë pa tvsh, kualifikuar; |
| 3. ”Bami” sh.p.k | 139,008,740 lekë pa tvsh, kualifikuar; |

II.4. Në datën 03.07.2017, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), autoriteti kontraktor ka njoftuar B.O.E “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tyre, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, për arsyet si më poshtë vijon:

“Pasi shqyrtoi KVO dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik MANE/S shpk & BE-IS shpk, konstatojme se:

1. Në pikën 2 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, pika 4, paragrafi 3 kerkohet që “operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar minimalisht 4 punonjës me deshmi për sigurimin teknik nga IQT ose ekuivalente si më poshtë: nje punonjës elektrikist; nje punonjës hidraulik; nje

teknik ndertimi; nje mekanik. Per punonjesit e me siperm duhet te paraqitet: kontrata e punes e vlefshme; deshmit e kualifikimit te sigurimit teknik, te figurojne ne listpagesat e shoqerise, dokument i kualifikimit profesional(per profesionet: elektrikist, hidraulik, teknik ndertimi, mekanik). KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh: punojesi elektrikist: kane kontrat individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kan deshmi ose dokument te kualifikimit profesional, me perjashtim te Hektor Bales i cili ka deftese shkollë si elektrikist, Gezim Muca deshmi kurs profesional dhe Ardian Muko me deshmi; punonjesi Hidraulik: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional; Teknik ndertimi: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional. Mekanik: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional me perjashtim te Feruz Xhallari i cili ka deshmi kursi privat; ne kete menyre BOE MANE/S shpk & BE-IS shpk nuk ploteson kerkesen e pikes 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” , nen piken 2.3 kapaciteti teknik, nen pika 4, paragrafi 3.

2. Ne piken 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” nen pika 4, paragrafi 3 kerkohet qe” operatoret ekonomik pjesmarres dueht te kene te punesuar, minimalisht 10 punonjes manovrator te mjeteve te renda. Per keto punonjes duhet te paraqitet: kontrata e punes se vlefshme, deshmit e kualifikimit te sigurimit teknik nga IQT, te figurojne ne listpagesat e shoqerise”. KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh , deshmi manovrimi nga 10 persona te kerkuar me te tille deshmi, vetem 8 jane paraqitur, dhe nga keto 2 jane me afat vlefshmerie noteriale te skaduar.

3. Ne piken 2. “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, nen pika 2.3 “Kapaciteti teknik” eshte kerkuar pervoje e suksesshme ne ekzekutimin e te pakten nje pune te ngjashme per nje kontrate te vetme te se njeites natyre me objektin qe prokurohet ne nje vlere prej 50% te vleres te fondit limit, te ekzekutuar gjat tre viteve te fundit te aktivitetit te operatorit ose . Kontrate pune te ngjashme ku vlere monetare totale e puneve e marre se bashku gjat tre viteve te fundit eshte ne nje vlere sa dyfishi i vleres limit te kontrates. 1.a. per kontrata te realizuara me subjekte shteterore duehet te paraqes: a- kontraten, b-situacion i perfunduar,c-akt kolaudimi ne punimeve te kryera, d- formulari i vleresimit per realizimin e punimeve, sipas shtojces 8; e- fature tatimore, f-certifikate e marrjes ne dorezim. 1.b. per kontrata te realizuara me subjekte private duhet te paraqes: kontrata, situacion perfundimtar, akt kolaudimi, fatura tatimore. Plotesimi i njerit prej 2 kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme; ne rast te bashkimit te operatoreve secili prej anetareve te bashkimit duhet te plotesoje kriterin e mesiperm. KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh , operatori BE-IS shpk , ka paraqitur pune te ngjashme te perputhur me kerkesen e DST duke siguruar plotesimin e kushtit te 1 te kerkeses perkatese 2.3 “Kapaciteti teknik”, ndersa operatori MANE/S shpk , ka paraqitur si pune te ngjashme vetem objektin “ Rikonstruksioni qendres se qytetit Konispol” me vlere te kolauduar 32.369.281 leke sipas procesverbalit te kolaudimit date 15.10.2015; paraqitja e ketij objekti te vetem per plotesimin e kerkesave te pikes 2.3 nen pika 2 kontrate pune te ngjashme ku vlere monetare totale e puneve te kryera e marre se bashku gjat tre viteve te fundit eshte ne nje vlere sa dyfishi i vleres limit te kontrates”, nuk e permbush kete kerkese te DST per pune te ngjashme sepse duhej te kishte paraqitur punime te dokumentuara e te kolauduara ne vleren shumatore 45.30% te dyfishit te vleres se fondit limit (45.30% te dyfishit te vleres se kerkuar 139.137.617) ose 126.058.681 leke. Ne kete menyre BOE MANE/S shpk & BE-IS shpk nuk ploteson kerkesen e pikes 2 “ Kriteret e vecanta te kualifikimit”, nen pika 2.3 “Kapaciteti teknik”.

4. Ne baze te shkreses Nr.1921 Prot 30.06.2017 drejtuar Drejtorise Rajonale Tatimore Sarande per kerkese per dhenie informacioni per Drejtuesit Teknik te shoqerise MANE/S shpk neqofte se jane te

punesuar ne institucione te tjera publike na eshte kthyer pergjigje nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarande me N.8418/1 Prot date 30.06.2017 na rezulton se : 1. Zeqir Matoshi me NID F51127081J per periudhen Janar 2012 deri ne Maj te 2017 figuron i dy punesuar ne subjektin MANE/S shpk me NIPT J64103865K dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit me NIPT J62325010Ë. 2. Z. Gjergj Klini me NID H00529081B, per periudhen Shkurt 2015 deri ne Maj 2017 figuron i dypunesuar ne subjektin MANE/S shpk me NIPT J64103865K dhe Operatorit te Shperndarjes se Energjise me NIPT K72410014H. 3. Z.Marseld Ahmetaj me NID I60508095L, per periudhen Qershor 2015 deri ne Maj 2017 figuron i dypunesuar ne subjektin : MANE/S me NIPT J64103865K dhe Drejtoria e ALUZIONI-T Tirane me NIPT L41330451N. Ne baze te VKM Nr.42 date 16.01.2008 KREU IV , “DREJTUESIT TEKNIK TE SHOQERISE DHE PAPAJTUESHMERIA ME KETE DETYRE” pika 2. Papajtueshmeria me detyren e Drejtuesit Teknik te shoqerise se zbatimit. Drejtuesit Teknik te shoqerise nuk mund te jene persona qe jane te angazhuar ne c’do punemarrje tjeter publike. Per keto arsye KVO s’kualifikon nga procedura e prokurimit publik “Rikonstruksioni i rruges kthesa e Pilurit(Himare)- Vumblo”, BOE MANE/S shpk & BE-IS shpk dhe i drejtohem i organeve kompetente per te marre masat administrative dhe penale ndaj subjektit MANE/S shpk me administrator Malo Mane per “Papajtueshmerine me detyren e Drejtuesit Teknik te shoqerise se zbatimit”.”

II.4.1. Në datën 07.07.2017 B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tyre, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më posht vijon:

“[...]I-Referuar arsyes se pare te skualifikimit te bashkimit tone te operatoreve, persa eshte kerkuar ne DT, citojme :

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 4 punonjës të kualifikuar te pajisur me deshmi per sigurimin teknik nga IQT ose Ekuivalente si më poshtë:

-1 Punonjës elektrikist; 1 Punonjës hidraulik; 1 Teknike Ndertimi; 1 Mekanik

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet:

kontrata e punës e vlefshme; deshmitë e kualifikimi te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente;

te figurojne ne listpagesat e shoqërisë dokumenti kualifikimit profesional (per profesionet: elektrikist, hidraulik, teknik ndertimi, mekanik).

Nga verifikimi i dokumentacionit te ngarkuar ne SPE per permbushjen e ketij kriteri rezulton se per Teknik Ndertimi, ne si bashkim operatoresh kemi paraqitur dokumentacion te plote provues per:

1. Malo Mane me Diplome nr. 10, te shkolles se mesme profesionale, me titull teknik i mesem ndertimi, leshuar ne date 12.1.1973, e shoqeruar me kartele te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme, i cili eshte i pasqyruar ne listpagesat e shoqeris dhe eshte administrator i shoqerise Mane/s sh.p.k. lng. Malo Mane eshte i diplomuar edhe si inxhinier ndertimi, cka provohet me diplomen e shkolles se lart me nr. 3940.

2. Preng Rica me deshmi kualifikimi profesionale, te leshuar ne date 30.6.1975, e shoqeruar me kartele te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE, te vlefshme, kontrate pune te vlefshme dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise Mane/s sh.p.k.

3. Shaban Selmani, me deshmi kualifikimi profesionale vertetim te leshuar nga Shkolla e mesme teknike profesionale, ne date 18.11.2015 nepermjet te cilit provohet se ne vitin shkollor 1988-1989 ka perfunduar shkollen e mesme te ndertimit, ne degen ndertim, e shoqeruar me kartele te sigurimit

teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme, kontrate pune te vlefshme dhe i pasqyruar ne listepagesat e shoqerise Mane/s sh.p.k.

4. Petrit Dema, mbajtes i defteses se pjekurise, me specializim ne Ndertim, me nr. Amze 4410 dhe nr. Rregj te vecante 639, i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme dhe kontrate pune te vlefshme dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k.

5. Ismet Islamaj, sipas vertetimit te leshuar nga shkolla e mesme "Karl Gega" me date 11.02.2013, ka kryer shkollen e mesme profesionale te ndertimit ne vitin 1986, ne degen Ndertim, i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme dhe kontrate pune te vlefshme dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k.

6. Sofokli Bega, mbajtes i defteses se pjekurise, me specializim ne Ndertim, me nr. Amze 56 dhe nr. Rregj te vecante 41 ka kryer shkollen e "mesme te ndertimit ne vitin 1985, i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM dhe kontrate pune te vlefshme dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k. ,

7. Hiqmet Vogli, mbajtes i defteses se pjekurise, me specializim ne Ndertim, me nr. Amze 2466 dhe nr. Rregj te vecante 2360 ka kryer shkollen e mesme profesionale te ndertimit ne vitin 1984, i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme dhe kontrate pune te vlefshme dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k.

Per I Mekanik kemi paraqitur ne SPE:

1. Feruz Xhallari, per te cilin kemi paraqitur dokument kualifikimi profesional, Certifikata per trajnim ne kursin e mekanikes, shoqeruar me kontrate pune te vlefshme, karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (i certifikuar si mekanik), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S sh.p.k.

2. Rustem Xhallari, per te cilin kemi paraqitur dokument kualifikimi profesional, Certifikate per trajnim ne kursin e mekanikes, shoqeruar me kontrate pune te vlefshme, karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (i certifikuar si mekanik), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S sh.p.k.

3. Endrit Shatku, per te cilin kemi paraqitur Diplome te Harry T. Fufts shkolla e mesme profesionale per mekanik ne date 08.07.2002 si dhe eshte diplomuar si inxhinier mekanik sipas diplomes nr. 3239, ne Universitetin Politeknik Tirane ne date 29.07.2009, shoqeruar me kontrate pune te vlefshme, karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (i certifikuar si ing. mekanik), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S sh.p.k.

4. Gazment Islamaj, per te cilin kemi paraqitur, kontrate pune te vlefshme si mekanik, karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme (i certifikuar si mekanik), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k.

5. Shyqiri Islamaj, per te cilin kemi paraqitur, kontrate pune te vlefshme si mekanik, karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme (i certifikuar si mekanik), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k.

Per I Elektracist kemi paraqitur ne SPE:

1. Hektor Balla i cili ka perfunduar shkollen e Mesme Teknike Elektrike sipas defteses se pjekurise me nr. Rregj, te vecante 1354 i specializuar elektrik, per te cilin kemi paraqitur kontrate pune te vlefshme si elektracist, karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme (i certifikuar si elektracist), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k.

2. Gezim Muca, per te cilin kemi paraqitur Certifikate kualifikimi per kursin profesional si instalues elektrik, te leshuar ne date 06.07.2015, shoqeruar me kontrate pune te vlefshme si elektracist, karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme (i certifikuar si elektracist), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise BE-IS sh.p.k.

3. Shoqeria Mane/S sh.p.k, ka pjese te stafit te tij dy ing. Elektrike, njeri nga te cilet mund te bejme me se mire punen e elektricistit, ndaj si te tille kemi paraqitur Mehmet Fikun i diplomuar si inxhinier elektrik, i pajisur me karte te sigurimit teknik , me kontrate pune dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S. Gjithashtu kemi paraqitur kontrata pune te vlefshme per Llaqi Boci dhe Asllan Rexhepi te punesuar si elektricist te cilet jane te pajisura me karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (te certifikuar si elektricist) si dhe te pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S sh.p.k.

4. Arjan Muka, i cili ka perfunduar Shkollen profesionale Elektrike sipas defteses se pjekurise me nr. Rregj. te vecante 35/44, certifikate e pergatitjes profesionale me nr. Rregj. te vecante 1325, i specializuar elektromekanik ne date 30.06.2006, per te cilin kemi paraqitur kontrate pune te vlefshme si elektricist, karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme (i certifikuar si elektricist), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise Mane/S sh.p.k.

5. Denis Stafa, i cili ka perfunduar shkollen profesionale Elektrike sipas diplomes te leshuar ne , dt. 16.07.2015, si dhe certifikate profesionale e nivelit te trete te leshuar nga shkolla e mesme profesionale i specializuar elektromekanik, ne date 08.07.2015, per te cilin kemi paraqitur kontrate pune te vlefshme si elektricist, karte te sigurimit teknik te leshuar nga HTM te vlefshme (i certifikuar si elektricist), dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise Mane/S sh.p.k.

Per 1 Hidraulik kemi paraqitur ne SPE:

1. Adriatik (Andrea) Haxhi, i cili ka perfunduar shkollen profesionale te ekonomise komunale, i kualifikuar sipas deshmise nr. 3810, i specializuar ne profilin Hidraulik ne vitin 1988, per te cilin kemi paraqitur kontrate pune te vlefshme si hidraulik, karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (i certifikuar hidraulik) dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S shpk.

2. Mikel Haxhi, i cili ka perfunduar kursin e trajnimit 6 mujor duke u specializuar ne profilin Hidraulik , per te cilin kemi paraqitur kontrate pune te vlefshme si Hidraulik, karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (i certifikuar hidraulik) dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S shpk.

3 Lavderim Jata, i cili ka perfunduar kursin e trajnimit 6 mujor duke u specializuar ne profilin Hidraulik, per te cilin kemi paraqitur kontrate pune te vlefshme si Hidraulik, karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (i certifikuar si hidraulik) dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S sh. p k.

4 Enxhel Lela, i cili ka perfunduar kursin e trajnimit 6 mujor duke u specializuar ne profilin Hidraulik ,per te cilin kemi paraqitur kontrate pune te vlefshme si Hidraulik, karte te sigurimit teknik te leshuar nga TCPE te vlefshme (i certifikuar si hidraulik) dhe i pasqyruar ne listpagesat e shoqerise MANE/S sh.p.k.

Persa i perket arsyes se dyte te skualifikimit citojme kerkesen e vendosur ne DT:

Operatorët ekonomik pjesemarrës duhet të kenë të punësuar, minimalisht 10 (dhjete) punonjës manovratorë të mjetëve të rënda. Për këto punonjës duhet të paraqitet : kontrata e punës e vlefshme; deshmitë e kualifikimit te sigurimit teknik nga IQT ose ekuivalente; te figurojnë ne listpagesat e shoqërisë; Deshmi Manovrimi.

Nga bashkimi jone i Operatoreve ne permbushje te kesaj kerkese, ka paraqitur :

Per Mane/S:

1. Klodi Veli -manovrator, kontrate pune te vlefshme (pa afat te percaktuar kohor), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese TCPE te vlefshme.

2. Genci Veli -manovrator, kontrate pune te vlefshme (pa afat te percaktuar kohor), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese TCPE te vlefshme.

3. Riza Peshku -manovrator, kontrate pune te vlefshme (pa afat te percaktuar kohor), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese TCPE te vlefshme.

4. Sokol Cane-automakinist (monovrator) kontrate pune te vlefshme (pa afat te percaktuar kohor), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese TCPE te vlefshme.

5. Taulant Hoxhaj automakinist (manovrator), kontrate pune te vlefshme (pa afat te percaktuar kohor), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese TCPE te vlefshme.

Per Be-Is sh.p.k:

1. Ylli Gura-manovrator eskavatorist, kontrate pune te vlefshme (22.09.2016 22.09.2017), deshmi manovrimi. figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM. te vlefshme.

2. Elez Kaboci -manovramr eskavatorist, kontrate pune te vlefshme (22.07.2016 22.07.2017), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese te vlefshme.

3. Nazmi Elezi -manovrator automakinist, kontrate pune te vlefshme (22.07.2016 22.07.2017), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur "me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

4. Andi Muja -manovrator eskavatorist, kontrate pune te vlefshme (22.07.2016 22.07.2017), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

5. Gjon Maklekaj -manovrator automakinist, kontrate pune te vlefshme (14.11.2016 14.11.2017), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

6. Spiro Daiu -manovrator, kontrate pune te vlefshme (27.01.2017 20.06.2017 kjo kontrate eshte rinovuar ne daten e perfundimit te saj, pasi eshte e vlefshme ne daten e hapjes se tenderit), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

7. Sokol Malo -manovrator eskavatorist, kontrate pune te vlefshme (27.01.2017 27.07.2017 kjo kontrate do te rinovohet ne daten e perfundimit te saj pasi eshte e vlefshme ne daten e hapjes se tenderit), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

8. Refki Tota -manovrator, kontrate pune te vlefshme (20.12.2016 20.06.2017 kjo kontrate eshte rinovuar ne daten e perfundimit te saj, pasi eshte e vlefshme ne daten e hapjes se tenderit), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

9. Bedri Ismailaj -manovrator, kontrate pune te vlefshme (07.01.2016 07.01.2018), deshmi manovrimi, figuron ne listapagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

10. Lazam Lushi -manovrator, automakinist, kontrate pune te vlefshme (20.12.2016 20.06.2017 kjo kontrate eshte rinovuar ne daten e perfundimit te saj, pasi eshte e vlefshme ne daten e hapjes se

tenderit), deshmi manovrimi, figuron ne listpagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

11. Ferit Sulollari -manovrator, kontrate pune te vlefshme (20.12.2016 20.06.2017 kjo kontrate eshte rinovuar ne daten e perfundimit te saj, pasi eshte e vlefshme ne daten e hapjes se tenderit), deshmi manovrimi, figuron ne listpagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

12. Ergis Isaj -manovrator, kontrate pune te vlefshme (13.10.2016 13.10.2018), deshmi manovrimi, figuron ne listpagesa dhe i pajisur me karte te sigurimit teknik te leshuar nga trupa akredituese HTM te vlefshme.

Te gjitha manovratorët si te shoqerise Mane/S sh.p.k dhe ata te shoqerise BE-IS sh.p.k jane te pajisur me kontrate pune te vlefshme ne daten e hapjes se tenderit theksojme ketu ne te gjitha kontratat e punes jane me te drejte rinovimi ne perfundim te afatit te tyre), me leje manovrimi, me kartela te sigurimit teknik te leshuara nga shoqerite e akredituara nga IQT per sigurim teknik, ne baze te ligjit si dhe jane te gjitha te pasqyruar ne listpagesat e shoqerive tona.

Ne keto kushte skualifikimi juaj eshte i pambeshtetur dhe nuk qendron ndaj kerkojme pranimin e ankeses dhe kualifikim tone, sepse kriteri i mesiper jo vetem eshte plotesuar por eshte tejkaluar, pasi ne disponojme 17 manovrator nga 10 qe AK ka kerkuar, te kompletuar me gjitha dokumentacionin e plote te kerkuar nga anajuar, dokumentacion ky i vlefshem plotesisht.

Duke marre ne analize arsyen e trete te skualifikimit sqarojme: Ju sjellim ne vemendje se oferta jone eshte paraqitur si bashkim operatoresh:

-Mane/S sh.p.k me -45.3% te pjesemarrjes

-Be-IS sh.p.k -54.7% te pjesemarrjes

Sipas parashikimit ligjore autoriteti kontraktor ne permbushje te kesaj pike, mund te kerkoje vetem pune te ngjashme dhe jo së njëjtës natyrë, ndaj ne keto kushte kur ky kriter i vendosur nga ana juaj eshte i paligjshem dhe diskriminues, ne si ofertues ne zbatim te nenit 46, pika 1, nuk kemi detyrimin ta permbushim. Megjithate ne respektojmë te nenit 74 te VKM 914 pika 3, ne kemi paraqitur te ngjashme dhe pune identike, e cila jo vetem e permbushen vleren e kerkuar (50% te fondit limit) por e tejkalojmë disa here:

”Rikonstruksion i Qendres Konispol dhe rruges hyrese ne te” me vlere te realizuar 38,845,612 leke. Sipas perlllogaritjeve kontrata e ngjashme: fondi limit 139.137.617 leke * 50% =69,568,808 leke Kontrat te ngjashme qe duhet te paraqese MANE/S sh.p.k me pjesemarrje 45.3% *69,568,808= 31,514,670 leke.

Po ti referohemi zerave te punimeve qe ka marre persiper shoqeria "MANE/S" sh.p.k, rezulton qe ka marre persiper te realizoje te zeri nr. 6 -siperfaqe bituminose do te kryej vetem shtresa asfalto betoni, zerin nr. 6.5 dhe nr.6.6, dhe te gjitha punimet e zerit nr. 7 te preventivit. Krahasimi i kontratave te ngjashme behet bazuar ne zerat kryesore te punimeve, nese kane ngjashmeri, me ato te percaktuara ne objektin e prokurim. [...]"

II.4.2. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 1983/1 Prot. datë 07.07.2017, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën, duke argumentuar si më poshtë vijon:

”[...] Ne piken 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, pika 4, paragrafi 3 kerkojme qe “operatori ekonomik pjesemarrës duhet te kene te punesuar minimalisht 4 punonjes me deshmi per sigurimin teknik nga IQT ose ekuivalente si me poshte: nje punonjes elektrikist; nje punonjes hidraulik; nje

teknik ndertimi; nje mekanik. Per punonjesit e me siperm duhet te paraqitet: kontrata e punes e vlefshme; deshmita kualifikimit te sigurimit teknik, te figurojne ne listpagesat e shoqerise, dokument i kualifikimit profesional(per profesionet: elektrikist, hidraulik, teknik ndertimi, mekanik). KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh: punojesi elektrikist: kane kontrat individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kan deshmi ose dokument te kualifikimit profesional, me perjashtim te Hektor Bales i cili ka deftese shkolle si elektrikist, Gezim Muca deshmi kurs profesional dhe Ardian Muko me deshmi; punonjesi Hidraulik: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional; Teknik ndertimi: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional. Mekanik: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional me perjashtim te Feruz Xhallari i cili ka deshmi kursi privat; ne kete menyre BOB MANE/S shpk & BE-IS shpk nuk ploteson kerkesen e pikes 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, nen piken 2.3 kapaciteti teknik, nen pika 4, paragrafi 3.

2. Ne piken 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” nen pika 4, paragrafi 3 kerkohet qe” operoret ekonomik pjesmarres duhet te kene te punesuar, minimalisht 10 punonjes manovrator te mjeteve te renda. Per keto punonjes duhet te paraqitet: kontrata e punes se vlefshme, deshmita kualifikimit te sigurimit teknik nga IQT, te figurojne ne listpagesat e shoqerise”. KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh , deshmi manovrimi nga 10 persona te kerkuar me te tille deshmi, vetem 8 jane paraqitur, dhe nga keto 2 jane me afat vlefshmerie noteriale te skaduar.

Ne piken 2. “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, nen pika 2.3 “Kapaciteti teknik” eshte kerkuar pervoje e suksesshme ne ekzekutimin e te pakten nje pune te ngjashme per nje kontrate te vetme te se njejtes natyre me objektin qe prokurohet ne nje vlere prej 50% te vleres te fondit limit, te ekzekutuar gjat tre viteve te fundit te aktivitetit te operatorit ose . Kontrate pune te ngjashme ku vlere monetare totale e puneve e marre se bashku gjat tre viteve te fundit eshte ne nje vlere sa dyfishi i vleres limit te kontrates. 1.a. per kontrata te realizuara me subjekte shteterore duhet te paraqes: a.kontraten, b-situacion i perfunduar-akt kolaudimi te punimeve te kryera, d.formular i vleresimit per realizimin e punimeve, sipas shtojces 8; e.fatura tatimore, f-certifikate e marrjes ne dorezim. 1.b. per kontrata te realizuara me subjekte private duhet te paraqes: kontrata, situacion perfundimtar, akt kolaudimi, fatura tatimore. Plotesimi i njerit prej 2 kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme; ne rast te bashkimit te operatoreve secili prej anetareve te bashkimit duhet te plotesoje kriterin e mesiperm. KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh , Operatori BE-IS shpk , ka paraqitur pune te ngjashme te perputhur me kerkesen e DST duke siguruar plotesimin e kushtit te 1 te kerkeses perkatese 2.3 “Kapaciteti teknik”, ndersa operatori MANE/S shpk , ka paraqitur si pune te ngjashme vetem objektin “ Rikonstruksioni qendres se qytetit Konispol” me vlere te kolauduar 32.369.281 leke sipas procesverbalit te kolaudimit date 15.10.2015; paraqitja e ketij objekti te vetem per plotesimin e kerkesave te pikes 2.3 nen pika 2 kontrate pune te ngjashme ku vlere monetare totale e puneve te kryera e marre se bashku gjat tre viteve te fundit eshte ne nje vlere sa dyfishi i vleres limit te kontrates”, nuk e permbush kete kerkese te DST per pune te ngjashme sepse duhej te kishte paraqitur punime te dokumentuara e te kolauduara ne vleren shumatore 45.30% te dytishit te vleres se fondit limit (45.30% te dytishit te vleres se kerkuar 139.137.617) ose 126.058.681 leke. Ne kete menyre BOB MANE/S shpk & BE-IS shpk nuk ploteson kerkesen e pikes 2 “ Kriteret e vecanta te kualifikimit”, nen pika 2.3 “Kapaciteti teknik”.

Ju sqarohet se pikën 4 për arsye neglizhence apo mos korrektese nuk e keni printuar nga SPE, që shpreh konkretisht si më poshtë:

4, Ne baze të shkresës Nr.1921 Prot 30.06.2017 drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore Sarandë për kërkesë për dhenie informacioni për Drejtuesit Teknik të shoqërisë MANE/S shpk neqoftë se janë të punësuar në institucione të tjera publike na është kthyer përgjigje nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë me N. 8418/1 Prot date 30.06.2017 na rezultoi se : 1. Zeqir Matoshi me NID F511270811 për periudhën Janar 2012 deri në Maj të 2017 figuron i dy punësuar në subjektin MANE/S shpk me NIPT J64103865K dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit me NIPT J62325010Ë. 2. Z. Gjergj Klini me NID H00529081B, për periudhën Shkurt 2015 deri në Maj 2017 figuron i dy punësuar në subjektin MANE/S shpk me NIPT J164103865K dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë me NIPT K72410014H. 3. z.Marseld Ahmetaj me NID I60508095L, për periudhën Qershor 2015 deri në Maj 2017 figuron i dy punësuar në subjektin : MANE/S me NIPT J64103865K dhe Drejtoria e ALUZNIT-Tiranë me NIPT L41330451N. Ne baze të VKM Nr.42 date 16.01.2008 KREU IV , “DREJTUESIT TEKNIK TE SHOQERISE DHE PAPAJTUESHMERIA ME KETE DETYRE” pika 2. Papajtueshmeria me detyrën e Drejtuesit Teknik të shoqërisë së zbatimit. Drejtuesit Teknik të shoqërisë nuk mund të jenë persona që janë të angazhuar në ç’do punëmarrje tjetër publike. Për keto arsye KVO s’kualifikon nga procedura e prokurimit publik “Rikonstruksioni i rruges kthesa e Pilurit(Himare)- Vumblo”, BOE MANE/S shpk & BE-IS shpk dhe i drejtohem organëve kompetente për të marrë masat administrative dhe penale ndaj subjektit MANE/S shpk me administrator Malo Mane për “Papajtueshmerinë me detyrën e Drejtuesit Teknik të shoqërisë së zbatimit”. [...]

II.4.3.Në datën 18.07.2017 B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.5. Referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP, konstaton se ankimuesi ka shtuar objektin e ankimit pranë KPP-së duke ngritur pretendime të reja shtesë mbi arsyet e tjera të skualifikimit, për të cilat pretendon se nuk është njoftuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.6.Në datën 31.07.2017, autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.2220/1prot., datë 27.07.2017, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në kuadër të shqyrtimit administrativ, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik në datën 21.08.2017 me anë të shkresës nr. 1288/4 protokoll datë 21.08.2017 i është kërkuar bashkimit të operatorëve ekonomikë “MANE/S“ sh.p.k dhe “BE-IS” sh.p.k. zhvillimi i një seance verifikimi në datën 23.08.2017 ora 09:30 pranë mjediseve të Komisionit të Prokurimit Publik, për verifikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, mbi njoftimin e arsyeve të skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor drejtuar llogarisë së përdoruesit të subjektit ankimues.

II.8. Në datën 23.08.2017 në prezencë të përfaqësuesit të operatorit ekonomik ankimues “Mane/S” shpk është zhvilluar seancë verifikimi mbi arsyet e skualifikimit njoftuar bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “MANE/S“ sh.p.k dhe “BE-IS” sh.p.k., në llogarinë individuale të përdoruesit të Sistemit të Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nga verifikimi rezultoi se në mesazhet elektronike të dërguara nga autoriteti kontraktor shfaqeshin të gjitha arsyet e skualifikimit.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesave të BOE ankimues,

Arsyeton:

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomikë ankimues, referuar materialeve të administruar në fashikullin e shqyrtimit administrativ, parashtrimeve me shkrim të ankimuesit dhe informacionit të autoritetit kontraktor, KPP konstaton se referuar informacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe parashtrimeve me shkrim të BOE ankimues, konstatohet se ky i fundit është i skualifikuar nga procedura e prokurimit objekt ankimi. Në lidhje me arsyet e skualifikimit, KPP *prima facia* konstatoi se referuar informacionit të dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr.2220/1prot., datë 27.07.2017, si edhe të trajtimit të ankesës nga ana e autoritetit kontraktor me anë të shkresës nr.1983/1 Prot. datë 07.07.2017 për bashkimin e operatorëve ekonomikë ankimues “MANE/S” sh.p.k & “BE-IS” sh.p.k, parashtrihen pretendimet se ankimuesi nuk është vënë në dijeni mbi të gjithë arsyet mbi skualifikimin e ofertës së tyre.

III.1.1. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik bëri verifikimet përkatëse në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, nga ku konstatoi se referuar të dhënave të gjeneruara nga Raporti i Auditimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, bashkimi i operatorëve ekonomikë “MANE/S” sh.p.k & “BE-IS” sh.pk është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me arsyet si më poshtë vijon:

“Pasi shqyrtoi KVO dokumentacionin e paraqitur nga Operatori Ekonomik MANE/S shpk & BE-IS shpk, konstatojme se: 1. Ne piken 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, pika 4, paragrafi 3 kerkohet qe “operatori ekonomik pjesmarres duhet te kene te punesuar minimalisht 4 punonjes me deshmi per sigurimin teknik nga IQT ose ekuivalente si me poshte: nje punonjes elektrikist; nje punonjes hidraulik; nje teknik ndertimi; nje mekanik. Per punonjesit e me siper duhet te paraqitet: kontrata e punes e vlefshme; deshmit e kualifikimit te sigurimit teknik, te figurojne ne listpagesat e shoqerise, dokument i kualifikimit profesional(per profesionet: elektrikist, hidraulik, teknik ndertimi, mekanik). KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh: punojesi elektrikist: kane kontrat individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kan deshmi ose dokument te kualifikimit profesional, me perjashtim te Hektor Bales i cili ka deftese shkolle si elektrikist, Gezim Muca deshmi kurs profesional dhe Ardian Muko me deshmi; punonjesi Hidraulik: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional; Teknik ndertimi: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional. Mekanik: kane kontrate individuale pune, kane deshmi per sigurimin teknik, nuk kane deshmi ose dokument te kualifikimit profesional me

perjashtim te Feruz Xhallari i cili ka deshmi kursi privat; ne kete menyre BOE MANE/S shpk & BE-IS shpk nuk ploteson kerkesen e pikes 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” , nen piken 2.3 kapaciteti teknik, nen pika 4, paragrafi 3.

2. Ne piken 2 “Kriteret e vecanta te kualifikimit” nen pika 4, paragrafi 3 kerkohet qe” operatoret ekonomik pjesmarres duhet te kene te punesuar, minimalisht 10 punonjes manovrator te mjeteve te renda. Per keto punonjes duhet te paraqitet: kontrata e punes se vlefshme, deshmit e kualifikimit te sigurimit teknik nga IQT, te figurojne ne lispagesat e shoqerise”. KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh , deshmi manovrimi nga 10 persona te kerkuar me te tille deshmi, vetem 8 jane paraqitur, dhe nga keto 2 jane me afat vlefshmerie noteriale te skaduar.

3. Ne piken 2. “Kriteret e vecanta te kualifikimit”, nen pika 2.3 “Kapaciteti teknik” eshte kerkuar pervoje e suksesshme ne ekzekutimin e te pakten nje pune te ngjashme per nje kontrate te vetme te se njejtes natyre me objektin qe prokurohet ne nje vlere prej 50% te vleres te fondit limit, te ekzekutuar gjat tre viteve te fundit te aktivitetit te operatorit ose . Kontrate pune te ngjashme ku vlere monetare totale e puneve e marre se bashku gjat tre viteve te fundit eshte ne nje vlere sa dyfishi i vleres limit te kontrates. 1.a. per kontrata te realizuara me subjekte shteterore duhet te paraqes: a- kontraten, b-situacion i perfunduar,c-akt kolaudimi te punimeve te kryera, d- formular i vleresimit per realizimin e punimeve, sipas shtojces 8; e- fature tatimore, f-certifikate e marrjes ne dorezim. 1.b. per kontrata te realizuara me subjekte private duhet te paraqes: kontrata, situacion perfundimtar, akt kolaudimi, fatura tatimore. Plotesimi i njerit prej 2 kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme; ne rast te bashkimit te operatoreve secili prej anetareve te bashkimit duhet te plotesoje kriterin e mesiperm. KVO konstaton se ne kete bashkim operatoresh , operatori BE-IS shpk , ka paraqitur pune te ngjashme te perputhur me kerkesen e DST duke siguruar plotesimin e kushtit te 1 te kerkeses perkatese 2.3 “Kapaciteti teknik”, ndersa operatori MANE/S shpk , ka paraqitur si pune te ngjashme vetem objektin “ Rikonstruksioni qendres se qytetit Konispol” me vlere te kolauduar 32.369.281 leke sipas procesverbalit te kolaudimit date 15.10.2015; paraqitja e ketij objekti te vetem per plotesimin e kerkesave te pikes 2.3 nen pika 2 kontrate pune te ngjashme ku vlere monetare totale e puneve te kryera e marre se bashku gjat tre viteve te fundit eshte ne nje vlere sa dyfishi i vleres limit te kontrates”, nuk e permbush kete kerkesa te DST per pune te ngjashme sepse duhej te kishte paraqitur punime te dokumentuara e te kolauduara ne vleren shumatore 45.30% te dyfishit te vleres se fondit limit (45.30% te dyfishit te vleres se kerkuar 139.137.617) ose 126.058.681 leke. Ne kete menyre BOE MANE/S shpk & BE-IS shpk nuk ploteson kerkesen e pikes 2 “ Kriteret e vecanta te kualifikimit”, nen pika 2.3 “Kapaciteti teknik”.

4. Ne baze te shkreses Nr.1921 Prot 30.06.2017 drejtuar Drejtorise Rajonale Tatimore Sarande per kerkesa per dhenie informacioni per Drejtuesit Teknik te shoqerise MANE/S shpk neqofte se jane te punesuar ne institucione te tjera publike na eshte kthyer pergjigje nga Drejtoria Rajonale Tatimore Sarande me N.8418/1 Prot date 30.06.2017 na rezulton se : 1. Zeqir Matoshi me NID F51127081J per periudhen Janar 2012 deri ne Maj te 2017 figuron i dy punesuar ne subjektin MANE/S shpk me NIPT J64103865K dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit me NIPT J62325010Ë. 2. Z. Gjergj Klini me NID H00529081B, per periudhen Shkurt 2015 deri ne Maj 2017 figuron i dypunesuar ne subjektin MANE/S shpk me NIPT J64103865K dhe Operatorit te Shperndarjes se Energjise me NIPT K72410014H. 3. Z.Marseld Ahmetaj me NID I60508095L, per periudhen Qershor 2015 deri ne Maj 2017 figuron i dypunesuar ne subjektin : MANE/S me NIPT J64103865K dhe Drejtoria e ALUZNI-t Tirane me NIPT L41330451N. Ne baze te VKM Nr.42 date 16.01.2008 KREU IV , “DREJTUESIT TEKNIK TE SHOQERISE DHE PAPAJTUESHMERIA ME KETE DETYRE” pika 2.

Papajtueshmeria me detyren e Drejtuesit Teknik te shoqerise se zbatimit. Drejtuesit Teknik te shoqerise nuk mund te jene persona qe jane te angazhuar ne c'do punemarrje tjeter publike. Per keto arsye KVO s'kualifikon nga procedura e prokurimit publik "Rikonstruksioni i rruges kthesa e Pilurit(Himare)-Vumblo", BOE MANE/S shpk & BE-IS shpk dhe i drejtohemi organeve kompetente per te marre masat administrative dhe penale ndaj subjektit MANE/S shpk me administrator Malo Mane per "Papajtueshmerine me detyren e Drejtuesit Teknik te shoqerise se zbatimit".

III.1.2. Për një shqyrtim të drejtë të pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues si edhe në kuadër të shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik në datën 21.08.2017 me anë të shkresës nr. 1288/4 protokoll datë 21.08.2017 i është kërkuar bashkimit të operatorëve ekonomikë "MANE/S" sh.p.k & "BE-IS" sh.p.k. zhvillimi i një seance verifikimi në datën 23.08.2017 ora 09:30 pranë mjediseve të Komisionit të Prokurimit Publik, për verifikimin në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, mbi njoftimin e arsyeve të skualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor drejtuar llogarisë së përdoruesit të subjektit ankimues.

III.1.3. Në datën 23.08.2017 në orën dhe vendin e përcaktuar në prezencë të përfaqësuesit të subjektit "MANE/S" sh.p.k, pajisur me autorizim nga administratori i shoqërisë, janë kryer veprimet procedurale të hyrjes në llogarinë e përdoruesit nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të subjektit ankimues dhe verifikimit të të dhënave të administruara në SPE në rubrikën "mesazhe" mbi arsyet e njoftuara të skualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Nga verifikimi i kryer rezultoi se në rubrikën "mesazhe", të llogarisë së përdoruesit të subjektit "MANE/S" sh.p.k. shfaqeshin të gjitha arsyet e skualifikimit dhe në përputhje me ato të konstatuara nga KPP në raportin e auditit të gjeneruar nga SPE.

III.1.4. Sa më sipër, pavarësisht pretendimeve të BOE ankimues "MANE/S" sh.p.k. & "BE-IS" sh.p.k., se mesazhet elektronike të plota, lidhur me arsyet e skualifikimit, janë shfaqur pasi ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP thekson se ky komision vendos vetëm bazuar në prova konkrete dhe konstatimet e kryera në kohë reale në sistemin e prokurimeve elektronike. KPP konstaton se BOE ankimues nuk arrin të vërtetojë me prova konkrete pretendimin lidhur me mosnjoftimin e të gjitha arsyeve të skualifikimit. Vlen të theksohet se në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSh" parashikohet se "Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj". Për këtë arsye, KPP gjykon se nuk mjafton vetëm pohimi i operatorit ekonomik ankimues për të vërtetuar pretendimin e mësipërm, sidomos kur këto pretendime nuk gjetën mbështetje as me anë të verifikimit e të dhënave të administruara në SPE në rubrikën "mesazhe" të llogarisë së përdoruesit të subjektit "MANE/S" sh.p.k., mbi arsyet e njoftuara të skualifikimit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, ku rezultoi se shfaqeshin të gjitha arsyet e skualifikimit në përputhje me ato të konstatuara nga KPP në raportin e auditit të gjeneruar nga SPE.

Sa më sipër, pretendimi i mësipërm nuk qëndron.

III.1.5. Sa më sipër, konstatohet se B.O.E ankimues "MANE/S" sh.p.k. & "BE-IS" sh.p.k. në ankimin e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, nuk ka ankimuar të gjitha arsyet e skualifikimit të tij nga kjo procedurë prokurimi, por ka ngritur pretendime vetëm për tre prej tyre nga katër të tilla, e rrjedhimisht ankimi i paraqitur prej këtij bashkimi nuk mund të konsiderohet si ezaurim i shkallëve që duhet të ndjekë një ankim administrativ, pasi ankimi në autoritetin kontraktor nuk është

realizuar sipas kritereve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Mosankimimi i arsyes të tjetër të skualifikimit bën që B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. të ngelet i skualifikuar, pasi për këtë arsye skualifikimi nuk janë ngritur pretendime pranë autoritetit kontraktor, si shkalla e parë e ankimit.

III.1.6. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.” Ky nen përcakton shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, B.O.E ankimues edhe pas ankimit në KPP rezultoi i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me tre arsyet e skualifikimit të tij, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës pasi, për arsyen e katërt të skualifikimit të këtij bashkimi operatorësh, nuk janë ngritur pretendime pranë autoritetit kontraktor, çka sjell se gjendja faktike dhe juridike e B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. do të vijojë të ngelet e skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht pa ndonjë interes për ankimuesin.

Në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e B.O.E ankimues “MANE/S” sh.p.k. & “BE-IS” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Rikonstruktion i rrugës Kthesë e Pilurit (Himarë) - Vumblo”, me nr. REF-13847-05-19-2017, me fond limit 139,137,617 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 16.06.2017, nga autoriteti kontraktor Bashkia Himarë.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vazhdojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së mësipërme të prokurimit.
 3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1288 protokoli Datë 18.07.2017;

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar

Leonard Gremshi

Anëtar

Hektor Balluku

Anëtar

Kleves Janku

Anëtar

Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha